



MEKANIZMI PËR KOORDINIMIN E EKSPERTIZËS

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe



ÇFARË ËSHTË MEKANIZMI PËR KOORDINIMIN E EKSPERTIZËS?

■ Mekanizmi për Koordinimin e Ekspertizës (MKE) është pjesë e një programi bashkëpunimi midis Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës, i quajtur Instrumenti Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë (referuar këtej e tutje si Instrumenti Horizontal), i cili ka për qëllim të mbështesë Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Kosovën*, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Malin e Zi, Serbinë dhe Turqinë në pajtueshmërinë e tyre me standardet evropiane. Instrumenti Horizontal ndjek një qasje plotësuese të dyfishtë: bashkëpunim teknik të përshtatur për të realizuar një rritje të pajtueshmërisë me standardet evropiane dhe sigurimin e ekspertizës së Këshillit të Evropës për t'iu përgjigjur kërkesave për ekspertizë ligjore dhe këshilla mbi politikat. Komponenti i fundit, ekspertiza ligjore dhe këshilla mbi politikat, quhet MKE.

ÇFARË ÇËSHTJESH MUND TË MBULOJË NJË KËRKESË PËR OPINION EKSPERTI NËN MKE?

■ MKE mbulon kërkesat për këshillim ad hoc eksperti për çështje legjislative dhe ato të politikave, të tilla si bërja e vlerësimeve nëse pjesë të caktuara të legjislationit dhe/ose dokumente të politikave janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës (të lidhura këto me reformat e Bashkimit Evropian për zgjerimin) në fushat e mëposhtme:

- ▶ sigurimi i drejtësisë
- ▶ lufta kundër krimit ekonomik
- ▶ anti-diskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël
- ▶ liria e shprehjes dhe e medias
- ▶ çështje kushtetuese, që bien brenda fushës së kompetencës së Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (i njohur më mirë si Komisioni i Venecias)

* Ky shënim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe Opinionin e GJND-së për Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

KUSH MUND TË BËJË KËRKESË PËR OPINION EKSPERTI NËN MKE?

Ministrat (dhe anëtarë të tjerë të qeverisë) ose Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, "ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë", Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë mund të bëjnë kërkesë për opinion ekspertit nën MKE. Për më tepër, kërkesë për asistencë nën MKE mund të paraqitet edhe për çështje që bien në mënyrë specifike në fushën e kompetencave të Komisionit të Venecias, Bashkimit Evropian si dhe të organeve të Këshillit të Evropës (p.sh. Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare dhe Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale). Gjithashtu, kërkesat për opinion të përmbledhur amicus curiae të Komisionit të Venecias mund të bëhen edhe nga gjykatat kushtetuese.

SI MUND TË BËHET NJË KËRKESË PËR OPINION EKSPERTI NËN MKE?

Kërkesa mund t'i drejtohet me shkrim me letër ose faks Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës, Z. Thorbjørn Jagland, dhe më pas do të përpunohet nga organi përkatës i Këshillit të Evropës. Kërkesat që përfshijnë ekspertizë të Komisionit të Venecias mund t'i drejtohen drejtpërsëdrejti Presidentit të Komisionit të Venecias, Z. Gianni Buquicchio. Mundësisht, kërkesa duhet të përmbajë sa më shumë detaje të jetë e mundur, duke përfshirë emrin dhe llojin e legjislacionit apo dokumentit të politikave për të cilin kërkohet ekspertizë, arsyet për kërkimin e ekspertizës ose për ndryshimin e legjislacionit, apo politikave, si dhe afatet kohore të parashikuara për miratimin e legjislacionit të ri apo dokumentin e politikave (ose ndryshimet në legjislacionin dhe dokumentet e politikave ekzistuese), pas dhënies së ekspertizës.

CILAT JANË KRITERET QË NJË KËRKESË TË MIRATOHET?

Një kërkesë nën MKE duhet të përmbushë të gjitha kriteret e mëposhtme:

- ▶ kërkesa duhet bërë nga një anëtar i qeverisë ose kryetari i parlamentit ose, nëse ajo ka të bëjë me një opinion amicus curiae, nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Malit të Zi, Serbisë dhe Turqisë (ose - në rast se kërkesa ka të bëjë me ekspertizë të Komisionit të Venecias - mund të bëhet edhe nga Bashkimi Evropian ose Sekretari i Përgjithshëm, Komiteti i Ministrave, Asambleja Parlamentare ose Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës);
- ▶ tematika e kërkesës duhet të bëjë pjesë në një nga fushat e ekspertizës së Këshillit të Evropës;
- ▶ tematika e kërkesës duhet të bëjë pjesë në fushat e mëposhtme: sigurimi i drejtësisë, lufta kundër krimit ekonomik, anti-diskriminimi dhe mbrojtja e të drejtave të grupeve vulnerabël, liria e shprehjes dhe e medias dhe/ose çështje kushtetuese që përfshihen në fushën e kompetencës së Komisionit të Venecias;



- ▶ kërkesa nuk mund të miratohet brenda formatit të një prej Veprimeve/ projekteve në vazhdim e sipër të komponentit të bashkëpunimit teknik të Instrumentit Horizontal.

SA KOHË DUHET PËR MIRATIN E EKSPERTIZËS?

■ Kohëzgjatja që i duhet Këshillit të Evropës për të ofruar ekspertizë për çdo lloj dokumenti mbi politikat apo legjislacioni mund të jetë e ndryshme dhe varet nga gjatësia dhe kompleksiteti i dokumentit për të cilin është kërkuar ekspertizë. Miratimi mund të kërkojë nga një muaj deri në një vit kohë. Ky afat kohor do të vendoset në konsultim me autoritetet kërkuese.

KUJT DUHET T'I DËRGOHET KËRKESA NËN MKE?

■ Kërkesa nën MKE mund t'i dërgohet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës me letër ose faks:

- ▶ Z. Thorbjørn Jagland
Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Evropës
Këshilli i Evropës
F-67075 Strasbourg Cedex – Francë
Fax: + 33 3 88 41 27 99

■ Kërkesat nën MKE që përfshijnë ekspertizë të Komisionit të Venecias mund t'i dërgohen edhe Presidentit të Komisionit të Venecias me letër, e-mail ose fax:

- ▶ Z. Gianni Buquicchio
Presidenti i Komisionit të Venecias
Këshilli i Evropës
67075 Strasbourg Cedex – Francë
Fax: +33 3 88 41 37 38
e-mail: venice@coe.int



KU MUND TË GJEJ MË SHUMË INFORMACION MBI MKE-NË?

■ Informacion mbi kërkesa të hershme nën MKE mund të gjenden në faqen e internetit të Instrumentit Horizontal (si dhe në faqen e internetit të Komisionit të Venecias, për kërkesa të përfshira nën kompetencat e tyre).

■ Pyetjet në lidhje me MKE-në mund të drejtohen pranë qendrës koordinuese të Instrumentit Horizontal ose pranë Zyrës së Drejtorit të Përgjithshëm të Programeve të Këshillit të Evropës, me e-mail, telefon ose letër:

- ▶ Horizontal Facility Co-ordination Hub
Zyra e Këshillit të Evropës në Beograd
Blue Center, Block 26, Building B
Spanskih Boraca 3
11070 Beograd, Serbi
E-mail: horizontal.facility@coe.int
Phone: +381 11 71 55 500
- ▶ Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm të Programeve
Këshilli i Evropës
Strasbourg Cedex 67075 FRANCE
E-mail: odgp@coe.int
Telefon: +33 39 02 14 631

MË SHUMË INFORMACION

► Website

<http://horizontal-facility-eu.coe.int>

► Facebook

jp.horizontal.facility

► Twitter

[@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

► Kontakt

Zyra e Këshillit të Evropës në Beograd

Blue Center, Block 26, Building B

Spanskih boraca 3

11070 Beograd

Serbi

Tel: +381 11 71 555 00

E-mail: Horizontal.Facility@coe.int

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e të drejtave të njeriut në kontinent. Ai përbëhet nga 47 shtete anëtare, 28 prej të cilave janë anëtarë të Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e së drejtës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Bashkimi Evropian është një partneritet unik ekonomik dhe politik mes 28 vendeve demokratike Europeane. Qëllimet e tij janë paqja, prosperiteti dhe liria për 500 milionë qytetarë të tij- në një botë më të drejtë dhe më të sigurtë. Me qëllim realizimin e këtyre objektivave, vendet e BE-së kanë ngritur organe për të drejtuar BE-në dhe për të miratuar legjislacionin e tij. Ato më kryesore janë Parlamenti Evropian (që përfaqëson popujt e Evropës), Këshilli i Bashkimit Evropian (që përfaqëson qeveritë kombëtare) dhe Komisioni Evropian (që përfaqëson interesat e përbashkëta të BE-së).

<http://europa.eu>

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Implemented
by the Council of Europe